



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 62, Datë 12.04.2024

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËKESËS SË SHOQËRISË “FU-GEN” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË FIER**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.04.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 886/1 prot., datë 09.04.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “FU-GEN” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në Bashkinë Fier”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “FU-GEN” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 886 prot., datë 04.04.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Aplikuesi ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se aplikuesi ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të përcaktimeve të nenit 9 të Rregullores, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”, për pikën 1.3 gërmat “a” dhe “c”; për pikën 2.1 gërmat “d”, “e” dhe “f”.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi konstatohet se nevojitet të plotësohet dokumentacioni si vijon:

## **NENI 9**

### **Formati dhe dokumentacioni për aplikim**

#### *Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ*

- **gërma “b”**: Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE dëshminë e penaltetit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për administratorin dhe shoqërinë “FU-GEN” sh.p.k.

#### *Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal*

- **gërma “b”**: Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës për mbështetjen financiare të investimit, referuar vlerës së këtij investimi në kontratën me MIE-n dhe mënyrën e financimit të parashikuar në planin e biznesit.

#### *Pika 2.1*

- **gërma “a”**: Aplikuesi duhet të saktësojë kapacitetin e instaluar dhe të plotësojë të dhënat me kapacitetin e secilës prej njësive gjeneruese.
- **gërma “b”**: Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE dhe kontratën e nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.
- **gërma “c”**: Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE sqarimet/korrigjimet përkatëse për shkresën e OSSH sh.a., për miratimin e pikës së lidhjes.
- **gërma “e”**: Aplikuesi duhet të informojë ERE-n në rast se ka filluar punimet për ndërtimin e centralit fotovoltaiik.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “FU-GEN” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 MW, me

vendndodhje në zonën kadastrale 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE NË DETYRË**

**Erjola SADUSHI**